

**Drejtuar: Qendra Kombetare e Rregjistrimit (QKR)**

**Lenda: RAPORT - Shnderrimi i shoqerise nga sh.p.k ne sh.a**

Une, i nenshkruari Berzh PIRANJANI ne cilesine e Administratorit te shoqerise "AUTO MASTER" sh.p.k., regjistruar ne Gjykaten e Tiranes me Vendim Nr. 37851, dt. 28.03.2007, me seli ne Tirane, Autostrada Tirane-Durres, km 12, Kashar, Tirane, me nr. NIPT K71618004V, kerkoj shnderrim te formes ligjore te shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar(sh.p.k), ne shoqeri aksionare me oferte private(sh.a) duke u bazuar ne arsyetimin e meposhtem:

1. Duke ju referuar objektit te veprimtarise se shoqerise "AUTO MASTER" sh.p.k , ku pervec te tjerave eshte parashikuar edhe tregetimi me pakice i vajrave lubrifikante, kerkoj qe te shtohet edhe **tregetimi me shumice i vajrave lubrifikante**. Ne baze te Ligjit nr. 8450 dt.24.02.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregetimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre" si dhe udhezimeve dhe vendimeve te Keshillit te Ministrave te nxjerra ne zbatim te ketij ligji, kerkohet qe tregetimi me shumice i vajrave lubrifikante te kryhet vetem nga ato shoqeri qe kane forme ligjore te shoqerive aksionare (sh.a).

2. Kapitali Themeltar i shoqerise AUTO MASTER sh.p.k, eshte aktualisht 20.000.000 (njezet milion) leke, i ndare ne 20.000 (njezet mijë) aksione, me vlere nominale 1.000 (nje mijë) lek secila, te gjitha keto te paguara dhe te zoteruara nga Ortaku i Vetem shoqeria "Union Grup" sh.p.k. Bazuar ne ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" per te patur statusin e Shoqerise Aksinere me oferte private kerkohet nje kapital jo me i vogel se 2.000.000 leke.

Ju faleminderit per bashkepunimin

**Me respekt**

**Berzh PIRANJANI**  
**Administrator**

